

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ABI PHARM" SHPK**

Sot më datë 21.07.2023 (dymjë e njezet e tre), themeluesi :

Sylejman Berisha, i biri i Halimit, lindur me 07.06.1961 ne Runjeve, Kacanik, Kosove dhe banues ne Prishtine, Rruga Leke Dukagjini, SU4/3, Nr.23, identifikuar me leternjostim nr. 2500152217.

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.B, kërkoi redaktimin e Akitit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I
EMERTIMI I SHOQERISE**

1.1 Emri i shoqërisë është "**ABI PHARM**" Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne Prishtine, Kosove: **Rruga Frosina Plaku, Kompleksi Magnet**
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përsaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuari mund te ushtroje ne baze te legjispcionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuari ne:



Ne fushën e tregtisë import – eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale dhe farmaceutik. Aktivitetet te keshillimit per biznes dhe keshillat e tjera per manashim. Agjencitë per publikitet, Tregtia me pakice e artikujve farmaceutike ne dyqane te specializuara.

Ne fusha te tjera, hapjen e bat buxave, restoranteve, pikave te servilit, parkimi autoimjetesh, lavazhit, hotelave, fshatrave turistik, motelave si dhe agjencive per shitblereje, dhene me qira te pasuri te tundshme dhe te patundshem, agjencive per shitblereje,

4.2 Per te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shqeria mund te veprime ne Shqiperi dhe jashtë, dhe te kryeje edo aktivitet tjeter te nevojsphem, te lidhur, instrumental, te perafert, elementar, ose sidogofte te dobishem, per shembull:

Te ofroje garanci reale dhe/ose personale si per detyrime te veta, ashtu edhe per te tretet. Te matre përsipër, te lejoje dhe lose te heqë dore nga pjesemarrje direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe te huaja, qe kryejne veprimitarne e tyre ana tyre, me qellim qe te lehtesojnë realizimin e objektit social; Veprimitari tregtar dhe industriale, import dhe eksport te mirash, shërbimesh dhe produktesh;

Ne kuadër te ligjit, te krijoje veprimitari dhe filiale te përfaqësimit.

NENI5 KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali i Shoqerisë është me 1000 Leke (njemije Leke), i shlyer plotësisht, me para, nga ortaku Z.Sylejman Berisha 1000 Leke ,(100%) te kuotave.
- 5.2 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqeri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjere. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqeri, duhet t'ia ofroje ketë kuote per blerje ortakeve te Shoqerisë. Brenda 30 (tridhjete) diteve nga ofrimi i kuotës per blerje, ortaket do te kenë te drejtë te blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës per te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqerisë, ortaket do te kenë te drejtë e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqerisë.

NENI6 KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotes dhe i te drejtave përkate se ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditave nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk ështe shprehur brenda asatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vleren e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.
- 6.2 Personi qe fiton te drejtë mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjeter te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar te drejtë mbi kuotën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotës.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe janë thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejtë mbi nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zotërojnë ne Shoqëri.
- 7.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit te pjesës se tyre, kapitali i panënskruar prej tyre mund te nenshkrhuhet nga ortaket e tjera. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë serish te drejtë mbi nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT



3

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zvogëloje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/o se çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim .
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (conference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme duhet te behet nëpërmjet njoftimit me shkrim osnj 11 e mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqërisë te paktën 7 (shtate) dite përpëra datës se caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do te mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë te pranishëm dhe bien dakord te vendosin ne lidhje me rendin e dites.



4

- 9.6 Mbledhjet e Asamblese se Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e përanishem.
- 9.7 Vendimet e Asamblese se Përgjithshme duhet të jene me shkrim dhe të firmosën nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakeve, vendimet duhet të perfshijnë dhe deklaratat apo vetejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet te pakten një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vittit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, perveçse per sa parashikon nenit 9.10 i ketij Akti Themelimi dhe Statuti, per vendime qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejtë vote ose perfaqesuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete per qind) te kapitalit te Shoqerise, sipas nenit 86 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro te te pakten 51 % te ortakeve pjesemarres (shumica e kualifikuar) ne baze te nenit 87 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare", per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

NENI10 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhe prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund te rizgjidhen dhe shkarkohen ne çdo kohe nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator: **Almir Dhimitri**
- 10.2 Administratori/t zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë, përveç veprimeve, përbushja e te cilëve i rezervohet Asamblesë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë dhe mund te autorizoje persona te trete, për te përbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë.



5

- 10.4 Administratoret nuk do te mund te marrin hua nga Shoqëria ose te lëshojnë garanci, dorëzani, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë, për hua dhe financime te dhëna nga te tretet.
- 10.5 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe vetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interesit, Administratori do te njoftoje menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI11
VITI FINANCIAR**

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

**NENI12
KONTROLI FINANCIAR**

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët ne baze te ligjit.

**NENI 13
BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimitarë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .
- 13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vtitit financiar.

**NENI 14
DIVIDENDET**

- 14.1 Ne përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

**NENI15
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE**



Gjon Miliqi 6

- 15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtronen juridiksonit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI16
GJUHA

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohej dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

NENI17
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

- 17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me ketë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne ketë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKU
SYLEJMAN BERISHA

